



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTERSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTITIJE - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS	
Njësia Org. Org. Jedmica Org. Umit	07-1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	744
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	03
Data: Datum: Date:	06.06.2018
Prishtinë a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i
Strateške Investicije - Ministry of Diaspora and Strategic Investments

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike bën:

Shpallje të Konkursit
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

<i>Emri i Institucionit:</i>	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike
<i>Njësia Organizative:</i>	Departamenti për Investime Strategjike
<i>Titulli i punës:</i>	Koordinator i aktiviteteve të Departamentit për Investime Strategjike
<i>Numri i referencës:</i>	MDIS/01/2018 /M.SH.V/9
<i>Tarifa e shërbimit:</i>	484 € bruto
<i>Raporton te:</i>	Drejtori i Departamentit për Investime Strategjike
<i>Lloji i kontratës:</i>	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
<i>Kohëzgjatja e kontratës:</i>	5 muaj e 29 ditë
<i>Orari i punës:</i>	I plotë
<i>Numri i ekzekutuesve:</i>	1 (një)
<i>Vendi:</i>	Prishtinë
<i>Data e fillimit:</i>	15.06.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron përkrahje administrative dhe teknike për stafin profesional dhe drejtues të departamentit për Investimet Strategjike në fushat kryesore të punës;
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bashkëpunon ngushtë me zyrtarët përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të departamentit;

- Koordinon aktivitetet e grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
- Koordinon aktivitetet në ofrimin këshillave për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
- Koordinon aktivitetet në ofrimin në ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon aktivitetet në punët me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme sipas autorizimit përkatës;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;
- Koordinon aktivitetet në ofrimin shpërndarjes së materialeve që lidhen me punën e MDIS-së;
- Kryen dhe detyra shtesë të deleguara nga Drejtori;
- Për punën e tij i përgjigjet Drejtorit për Investime Strategjike.

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë Universitare – shkenca shoqërore;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Njohja e mirë e MS-Office dhe Internetit;
- Njohja e gjuhës Angleze e dëshiruar;
- Aftësi në punë nën presion dhe fleksibilitet.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike / Divizioni për Burime Njerëzore, Rr. "Zenel Salihu", objekti i ish-Gjykatës Themelore të Prishtinës, kati përdhese ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <http://medrks-gov.net/>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni zyrën e Divizionit për Burime Njerëzore.

Tel. 038 200 17 024, prej orës 8:00 – 16:00.

- *Konkursi mbetet i hapur 7 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **06. 06. 2018** deri më: **12. 06. 2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.*
- *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda ditëve sa shpallja mbetet e hapur; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*
- *Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.*
- *Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!*
- *Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.*
- *Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit. Ata janë të obliguar t'i sjellin me vete dokumentet origjinale për kualifikimet dhe trajnimet e kryera, për verifikim para komisionit intervistues.*

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.